Kronikë

Sollën kallashnikov nga Korça në Tiranë me autobusin e linjës, 2 të rinj arrestohen në terminal (EMRAT)

Florjan Kollonata, 27 vjeç, nga Korça dhe Xhentino Pllana, 28 vjeç, nga Pogradeci, të dy banues në Tiranë, u arrestuan nga policia e kryeqytetit rreth mesditës së të shtunës në terminalin jug-lindor të autobusëve, pasi po transportonin një kallashnikov nga Korça për në kryeqytet

Kallashnikov

Sokol Dema
9 Mars, 14:06 | **Përditesimi: 9 Mars, 14:45**

Share

Tirane- Florjan Kollonata, 27 vjeç, nga Korça dhe Xhentino Pllana, 28 vjeç, nga Pogradeci, të dy banues në Tiranë, u arrestuan nga policia e kryeqytetit rreth mesditës së të shtunës në terminalin jug-lindor të autobusëve, pasi po transportonin një kallashnikov nga Korça për në kryeqytet.

Kapja e tyre është bërë pas informacioneve që policia mundi të sigurojë përmes rrugëve informative, ndërsa arma ishte mbështjellë me batanije dhe e futur në një çantë të madhe.

Dy djemve iu gjet me vete edhe një thikë buke, ndërsa iu sekuestruan edhe 3 aparate celular. Nga Korça dy shokët erdhën me autobus të linjës.

[Sh.com]
LEXO EDHE:
Prindërit të alarmuar në polici! 20-vjeçarja largohet nga banesa në Tiranë, edhe e mitura i ikën nënës në Shkodër

Akoma nuk dihet arsyeja e sjelljes së armës në Tiranë, ndërsa kanë nisur hetimet për të zbardhur të plotë ngjarjen. Arma do të dërgohet në laborator për ekspertizë, për të parë nëse është përdorur në krime të tjera.

M.Q./S.G/Shqiptarja.com

TAG: florjan kollonata | xhentino pllana | Tirane | arme

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Kë po dëmton kaosi në Kuvend?

Qeverinë | Opozitën | Qytetarët

Lajme të tjera

Fushata e anëtarësimeve të reja, Veliaj në terren: Dera e PS e hapur për të gjithë
10 Mars, 12:47

Të dënuar për rrëmbim, dhunë dhe shkatërrim prone, ekstradohen dy shqiptarë nga Britania dhe Gjermania
10 Mars, 11:30

FOTO+VIDEO/ Shoferit i bie të fikët në timon, aksidentohet autobusi i linjës së 'Unazës' në Tiranë
10 Mars, 10:26

'Duam fitoren për kreun', Orges Shehi: Partizani s'është i plotë
9 Mars, 21:43

Muzeu Historik për 4 vjet i mbyllur! Ministria kërkon një drejtor për të! Rikonstruksioni merr një vit më shumë kohë se ndërtimi në vitin 1981! Ja si do të financohet projekti
9 Mars, 20:48

Grushta në Kategorinë e Parë, lojtarët përplasen në korridoret e stadiumit
9 Mars, 15:37

Vëzhgimi i Report Tv, duhani i grirë shitet pa pullë në rrugët e Tiranës! Konsumohet nga rreth 30%, dëm shtetit deri në 80 mln euro

Freard Rista

9 Mars, 13:27

VIDEO/ Italiani humbi në Dajt, policia e gjen pas 5 orë kërkimesh
9 Mars, 10:56

Lëvizte u armatosur, në pranga 34-vjeçari në Tiranë
9 Mars, 10:26

Arrestohet me pistoletë në makinë nipi i Armando Dukës! Edevaldo Haxhiu ndihmoi të fshihej në Shqipëri bosin turk të kriptovalutave, Faruk Ozer (VIDEO)
9 Mars, 09:49

VIDEO/ Dita ndërkombëtare e grave, protestë para kryeministrisë! Protestueset djegin reçipetat: Poshtë patriarkati!
8 Mars, 19:20

Prej 2 vitesh luftonte për jetën në Francë, zyshë Ina mbërrin në atdhe! Shqiptarët mblodhën shumën për transportin me charter mjekësor
8 Mars, 16:28

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje